



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.853/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga:** Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë rishqyrtuar ankesën, sipas Aktgjykimit Anr.793/2020 të datës 01.09.2021 të pranuar në Këshill me datë 07.10.2021 me nr. protokoll 4944/21, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.43/2020 të datës 21.02.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë: kundër organit të punësimit-Institucioni i Avokatit të Popullit, në çështjen juridike “mos zbatimi i Vendimit nr.10/2020 të datës 23.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.43/2020 e datës 21.02.2020 e parashtruar nga ankuesi

**II.MBETET në fuqi** Vendimi Nr.10/2020 i datës 23.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit, për njohjen e përvojës së punës, të nëpunësit civil sipas Vendimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës me Nr.06/29 të datës 15.05.2015 nenit 6 dhe nenin 7 të këtij vendimi.

**III.OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi .

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Me datës 03.09.2019 Divizioni i Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit, ka nxjerrë vendimin nr.181/2019 me të cilin ankuesit nuk i është njohur përvoja e punës e deklaruar për periudhën kohore prej 01.01.1991 deri me datës 31.05.1996 në deklaratë nën betim tek noteri me datë 26.06.2015 LRP me numër rendor 1771/2015 i cili ka qenë i punësuar në biznesin privat DPT “Doni” në Gjilan dhe deklarimet me numër rendor 4931/2015, në N.SH.A. EuroKOS në Prishtinë.



Ankuesi i pakënaqur me vendimin nr.181/2019 te datës 03.09.2019 të Divizionit te Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit, me datë 03.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili me datës 04.11.2019 ka nxjerre vendimin me nr.67/2019 duke aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke obliguar Divizionin e burimeve Njerëzore në IAP, që të bëjë shqyrtimin e dokumentacioneve të noteriale të prezantuara nga \_\_\_\_\_ për dëshminë e përvojës së punës të trajtojnë në përputhje me nenin 3 par.4 të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë.

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, në pozitë ‘‘Drejtore i Departamentit të Administratës’’, ka parashtruar ankesë me datës 12.11.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionit të Avokatit të Popullit, për mos njohjen e përvojës së punës, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.06/29 të datës 15.05.2015, i cili ka dëshmuar me deklaratën nën betim të lëshuar nga noteri.

Me datës 23.01.2020 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, pasi ka pranuar vendimin e datë 12.11.2019 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Institucionin të Avokatit të Popullit, ka nxjerrë Vendimin me Nr. 10/2020 duke aprovuar ankesën e nëpunësit civil \_\_\_\_\_ për njohjen e përvojës së punës, duke obliguar Divizionit të Burimeve Njerëzore të Institucionin të Avokatit të Popullit, që brenda 15 ditë në përputhje me Vendimin Nr.67/2019 të datës 04.11.2019 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit të trajtoj dokumentet e noteriale të prezantuara nga \_\_\_\_\_ si dëshmi të përvojës se punës, në përputhje me nenin 3 të paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë.

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datës 21.02.2020, për mos zbatim te Vendimit me Nr. 10/2020 të datë 23.01.2020 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 409/2020, lidhur me njohjen e përvojës së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.03.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Institucioni i Avokatit të Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit më datë 12.03.2020 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Ankuesi me datë 13.05.2020 është njoftuar me Njoftimin me numër protokollit 861/20, lidhur me pa mundësin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit \_\_\_\_\_ të datës 21.02.2020, dhe që të vazhdoj me mjetin juridik për inicim të konflikt administrativ me padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Mbi këtë bazë ankuesi ka ushtruar mjetin juridik me krekës padi dhe me datë 01.09.2021 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka nxjerr Aktgjykim A.nr.793/2020 me të cilin i ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të vendos lidhur me ankesën e datës 21.02.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimi i datës 07.10.2021 nr. protokollit 4944/21 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 13.05.2020; Ankesën me numër protokollit 409/2020 të datës 21.02.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.10/2020 i datës 23.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit; E-mail i datës 23.01.2020 ½ faqe; shtojca 3 e datës 02.07.2020 me 1/7 faqe; **Përgjigje në ankesë** e datës 05.03.2020 nr. protokollit 594/20 prej 1/5 faqe; Lista e nëpunësve për përvojë te punës; Vendim nr.10/2020 i datës 23.01.2020-prova 1; Vendim nr.06/29 i datës 15.05.2015-prova 2; E-mail i datës 21.05.2015 (prova 3); Procesverbal i datës 25.05.2015- prova 4;E-mail i datës



26.05.2015 (prova 5); E-mail i datës 26.05.2015 –prova 6; E-mail i datës 26.05.2015 –prova 6a; Procesverbal i datës 08.07.2015 –prova 7; Deklarata nën betim e noterizuar me nr. rendor 4931/2015-prova 7a prej ½ faqe; kopje e lëshuar nga Noteri LRP. Nr. rendor: 1770/2015; Email i datës 14.07.2021 –prova 8; Email i datës 20.07.2015 prova 9; Kërkesë e datës 24.06.2019 me nr. protokolli 42/2019-prova 10; Opinjon Ligjor i datës 06.08.2019 nr. 24/2019 nga MAP-prova 11; Vendim nr.181/2019 i datës 03.09.2019-prova 12; Vendim nr.67/2019 i datës 04.11.2019-prova 13; Vendim nr.257/2019 i datës 12.11.2019-prova 14; kërkesë e datës 02.03.2020 –prova 15; Ankesa nr.267/2019 e datës 25.11.2019 për Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar provat e lëndës veç e veç nga ankuesi dhe organi i punësimit të dërguar në KPMSHC, dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuar lidhur me mos zbatimin e Vendimit me Nr.10/2020 të datës 23.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, për njohjen e përvojës së punës sepse në provat e lëndës të ankuesit është vërtetuar se ankuesi në deklaratën nën betim të lëshuar nga noteri me datë 26.06.2015 akt noterial LRP prej 01.01.1991 deri me datës 31.05.1996 në deklaratë nën betim tek noteri me datë 26.06.2015 LRP me numër rendor 1771/2015 i cili ka qenë i punësuar në biznesin privat DPT "Doni" në Gjilan dhe deklarator me numër rendor 4931/2015, në N.SH.A. EuroKOSË në Prishtinë në periudhën 1996-1999.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit, me datë 26.12.2019 i është drejtuar Odes së Noterëve për opinion ligjor lidhur me validitetin e deklaratës nën betim, si dokument për njohjen e përvojës së punës, i cili me datës 17.01.2020 ka dhënë opinionin ligjor lëshuar nga Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve, duke theksuar se: **"deklarata nën betim e palëve paraqet dokument noterial, sipas ligjit dokumentet noteriale të lëshuara në përputhje me ligjin kanë fuqinë e dokumenteve publike ndaj ato dhe kanë fuqinë provuese e në rastet e caktuara sipas ligjit kanë fuqi përmbarese dhe e gëzojnë supozimin e dyfishtë të ligjshmërisë....."**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.10 të datës 23.01.2020 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.10/2020 duke vërtetuar se Divizioni i Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit, me vlerësimin e deklaratave nën betim të pranuar nga ankuesi si prova të paraqitura për njohjen e përvojës së punës, mund të konstatohet vetëm përmes procedurës gjyqësore, të përcaktuara në nenin 3 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë, i cili përcakton se: **"Vërtetësia dhe zbatueshmëria e dokumenteve noterizuara bazohen në nënshkrimin, formën dhe përmbajtjen e dokumentit. Dokumentet e noterizuara gëzojnë supozimin e dyfishtë të ligjshmërisë. Ato mund të kontestohen vetëm përmes procedurave gjyqësore"**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.10 të datës 23.01.2019 ka aprovuar ankesën e ankuesit duke obliguar Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit, që tij bëjë njohjen e përvojës së punës, të nëpunësit civil sipas vendimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës me Nr.06/29 të datës 15.05.2015, të trajtoj dokumentet e noteriale të prezantuara nga si dëshmi të përvojës së punës, në përputhje me nenin 3 të paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë, brenda afatit prej 15 ditëve, të cilin obligim nuk e ka përmbushur organi i punësimit/ Institucionin e Avokatit të Popullit.





Andaj, mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Institucionin e Avokatit të Popullit, në rastin e mos zbatimit të Vendimit me Nr.10 të datës 23.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ka vepruar në kundërshtim me nenin 82 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: **“Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse”**, dhe mbi bazë të kësaj dispozite organi i punësimit Institucionin i Avokatit të Popullit, respektivisht Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, është i obliguar që t’i ndërmerr të gjitha veprimet juridike në pajtim me dispozitën e lartcekur, duke bërë zbatimin e Vendimit me Nr.10/2020 të datës 23.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit, në pajtim me 82 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin N.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse vendimi si i tillë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, po ashtu duke obliguar dhe njësinë e personelit në Institucionin e Avokatit të Popullit që në pajtim me nenin 6 dhe nenin 7 të Vendimit me Nr.06/29 të datës 15.05.2015 të Qeveris së Republikës së Kosovës, të vendos për njohjen e përvojës së punës së nëpunësit i cili realizon pagën nga buxheti i Kosovës, dhe vendimi i përvojës së punës të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.853/2021.**

Zyle Millaku **GOJNOVCI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Avokatit të Popullit;
- Gjyqtares së Gjykatës Themelore në Prishtinë
- Menaxherit të Personelit në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Eshref **SHABANI**

Kryetar i Kolegjit